



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË  
GJIP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA  
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

	NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A. GJIP "AUTOBUSKA STANICA" A. D. MPE "BUS STATION" J. S.		
Nr. No.	211340	Data Date	14.08.2019
PRISHTINË/A			

## RREGULLORE PËR PARANE E GATSHME - ARKA

Prishtinë, Prill 2019

N.P.L " Stacioni i Autobusëve"SH.A. - Prishtinë  
Rr. Bill Clinton, p.n – Prishtinë/ Kosovë  
+383 (38) 55 00 11  
[info@sap-rks.com](mailto:info@sap-rks.com)  
[www.sap-rks.com](http://www.sap-rks.com);

**Me qellim të implementimit të Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK), Standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), Ligjit për tatim në të ardhura të korporatave (Ligji Nr. 03/L- 162), Ligjit për shoqëritë tregtare (Ligji Nr. 06/L-016), Ligjit për Ndërmarrjet publike (Ligji Nr. 03/L-087), Ligjit për menaxhimin e financave publike (Ligji Nr. 03/L-048) Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” SH.A. në Prishtinë, Bordi i drejtoreshave ne takimin e mbajtur me date 5.04.2019 miraton: Rregulloren për Paranë e Gatshme - ARKA**

## **Afarizmi i arkës**

### **Neni 1**

Për nevoja të blerjeve të vogla dhe të natyrës urgjente, ndërmarrja mban para të gatshme në arkë, me të cilat para apo shumë të mjeteve udhëheq arkëtari.

### **Neni 2**

Limiti maksimal i lejuar në bazë të kësaj rregulloreje, për mbajtjen e parave të gatshme në arkë është në lartësinë: **250€** (Dyqind e pesedhjete) euro për arkën qendrore të ndërmarrjes,

Limiti maksimal i lejuar në bazë të kësaj rregulloreje, për mbajtjen e parave të gatshme në arkë është në lartësinë: **50.00€** (pesedhjet) euro për porto arkat apo sportelet të ndërmarrjes,

### **Neni 3**

Blerjet maksimale me para të gatshme janë të lejuara deri në shumën 100,00€ (njëqind) €,

### **Neni 4**

Për çdo transakcion me para të gatshme arkëtari plotëson urdhëresat e arkës të cilat kontrollohen dhe vërtetohen nga personat përgjegjës,

### **Neni 5**

Arkëtari e mban ditarin e arkës në baza ditore, në fund të çdo dite të punës mbyll Librin e arkes ditarin, urdhërin e arkës inkaso, urdhërin e arkës paguaj, obligohet ta bëjë bartjen e gjendjes fillestare për çdo ditë me rastin e mbylljes së ditarit, ta paraqes shumën totale të arkëtuar, shumën totale të paguar dhe ta paraqes gjendjen e re të parasë së gatshme në ditën e caktuar.

### **Neni 6**

Për çdo tejkalim të limitit të arkës {maksimumi i arkës}, arkëtari është i obliguar që të bëjë depozitimin e parave në llogarinë bankare të ndërmarrjes.

### **Neni 7**

Arkëtari obligohet që para përfundimit të orarit të punës së paku deri në ora 15:00h, për secilën ditë të punës të dorëzoj paratë në xhirollogarinë e ndërmarrjes në njëren prej bankave komerciale që punojnë në Kosovë. Arkëtari duhet të sigurohet që do ti barti paratë sigurtë deri në selinë e bankës apo xhirollogarinë e kompanisë.

### **Neni 8**

Likuidatorët janë të obliguar që të shkarkojnë dhe barazojnë porto arkat, të cilët me dokument intern e shkarkojnë porto arkën dhe e ngarkojnë arkën kryesore të NP.

### **Neni 9**

Arkatar kryesor është i obliguar që me rastin e pranimit të parave nga liuidatori (porto arkat) të lëshoj dokumentin e arkës inkaso.

### **Neni 10**

Arkatar kryesor me rastin e pagesave të imëta me para të gatshme, gjithënjë deri në limitin e lejuar prej 100.00€, ka obligim që të lëshoj dokumentin e arkës paguaj.

### **Neni 11**

Ditari i arkës, urdhëri i arkës inkaso dhe urdhëri i arkës paguaj janë tre dokumente obligative me të cilat është i ngarkuar Arkëtar kryesor, evidence mund të udhëheqet në format elektronik-komputer ose dokumentet standarde të lejuara me ligjin e ATK-së dhe procedurat.

### **Neni 12**

**EVIDENCA E ARKËS-Kuptimi i shprehjeve:**

- Arka – është vendi në ndërmarrje ku bëhet arkëtimi, ruajtja dhe pagesa e parasë.
- Arkëtar – është personi që punon në arkë.
- Çdo veprim në arkë mbështetet në dokumentacionin përkatës të verifikuar si: fletëpagesa, llogaria, fatura, dëftesa, kupon fiskal etj.
- Arkëtimet janë të gjitha pranimet e parasë së gatshme në arkë.
- Pagesat janë të gjitha dhëniet e parasë së gatshme nga arka.

### Neni 13

Dokumentet përcjellëse të evidencës së arkës

Me rastin e arkëtimit:

- Çeku i arkës
- Kuponat dhe faturat e shitjes
- Dëftesa e arkëtimit

### Neni 14

Me rastin e pagesës:

- Kuponat dhe faturat e blerjes
- Fletëpagesat e pagave
- Dëftesa e pagesës
- Dokumente tjera që dëshmojnë pagesë të ndryshme.

### Neni 15

Dokumentet e evidences së xhirollogarisë

Xhirollogaria apo llogaria rrjedhëse është arka e ndërmarrjes jashtë selisë së NP, xhirollogaria është një konto e çelur në një, dy apo ma shumë banka komerciale të licencuara në Kosovë.

- Hapja e llogarisë bankare bëhet në pajtim me rregullat dhe kërkesat e bankës përkatëse,
- Depozitimi, vendosja e parave në llogari bankare bëhet me mandat arkëtimi,
- Tërheqja në kesh apo transferi në ndonjë llogari tjetër bankare bëhet me mandat pagesë ose me çek.

### Neni 16

Shembull i regjistrimit në kontabilitet të xhirollogarisë

- Raporti bankar - përfshinë ndryshimet e ndodhura në llogarinë bankare të evidentuara nga banka.
- Konto xhirollogaria - përcjell gjendjen e llogarisë të evidentuar nga ndermarja.

Debi	Xhirollogaria	Kredi	Debi	Raporti Bankar	Kredi
Gjendja Fillestare				Gjendja Fillestare	
Depozitimet (Rritja e llogarisë)	Terhjeqjet (Zvogëlimi i llogarisë)		Terhjeqjet (Zvogëlimi i llogarisë)	Depozitimet (Rritja e llogarisë)	

Ditari i arkës është llogari dyanësore ku mbahen evidencat mbi gjendjen, hyrjet dhe daljet e parasë.

**LIBRI ( DITARI ) I ARKËS**

**FORMAT I NJË DITARI TË ARKËS**

**DITARI I ARKËS**

dt: **31.03.2019**

NR	Dokumenti		Përshkrimi	Hyrje	Dalje
	Hyrje-Inkaso	Dalje-paguaj			
a	b	c	d	e	f
1	UIXX001121		Pazari ditor, sporteli nr. 1	1,225.00	
2	UIXX001122		Pazari ditor, sporteli nr. 2	825.00	
3	UIXX001123		Pazari ditor, sporteli nr. 2	480.00	
4	UIXX001124		Pazari ditor, porto arka	1,140.00	
5		UPxx000001	Blerje material zyre		85.00
6		UPxx000002	Blerje e flesh diskut		22.00
7		UPxx000003	Blerje e materialit sanitar		43.00
8		UPxx000004	Blerje e materialit tjetër		99.00
9		UPxx000005	Dorzim i pazarit ditor		2,821.00
10					


Copë	Vlera	Gjithsej
1	500	500
1	200	200
1	100	100
1	50	50
2	20	40
1	10	10
7	5	35
8	2	16
32	1	32
20	0.5	10
21	0.2	4.2
28	0.1	2.8
<b>Totali</b>		<b>1,000.00</b>

Xhiro Arka	<b>3,670.00</b>	<b>3,070.00</b>
Sallo ditore: {E-F}	{3,670.00 - 3,070.00}	
	<b>=600.00</b>	

Sallo e arkës në fillim	400.00
Xhiro Arka ditore	600.00
Sallo e arkës në fund	<b>1,000.00</b>

## Neni 17

Evidenca e Xhirollogarise



## Neni 18

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas aprovimit nga Bordi i drejtorëve dhe nënshkrimit nga kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv, rregullorja duhet të publikohet në faqen zyrtare që disponon NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A .

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve:

**Faton Raci**

